

V E N D I M
Nr.3, datë 9.2.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i““““
Manol Konomi,	Anëtar i““““
Zija Vuci,	Anëtar i““““
Franc Jakova,	Anëtar i““““
Alfred Karamuço,	Anëtar i““““
Metush Saraçi,	Anëtar i““““
Veli Budo,	Anëtar i““““

me sekretare Drita Filto, në datat 13.12.1995, 21.12.1995 dhe 9.2.1996, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.20/4 Akti, që u përket:

K E R K U E S E : GJYKATA E RRETHIT VLORE

PERSON I INTERESUAR :

1. KESHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga ministri i Drejtësisë Z. Hektor Frashëri, ministri i Brendshëm Z. Agron Musaraj.

2. PROKURORIA E PERGJITHSHME, e përfaqësuar nga Zv/Prokurori i Përgjithshëm Z. Gani Dizdari.

O B J E K T I

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr.7873, datë 16.11.1994 “Për sekuestrimin e mjeteve tokësore, detare e ajrore me të cilat kryhen vepra penale”, për arsye se ky ligj vjen në kundërshtim me Kodin e Ri të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Gjykata e rrethit Vlorë ka pezulluar gjykimin e kërkesës së paraqitur nga qytetari M.I., i cili është ankuar për sekuestrimin e një motogomone, pronë e tij, vendosur nga Komisariati i Policisë Vlorë në bazë të ligjit nr.7873, datë 16.11.1994. Ajo i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar shpalljen e ligjit të mësipërm si antikushtetues sepse vjen në kundërshtim me Kodin e Ri të Procedurës Penale.

Gjykata e rrethit Vlorë është mbështetur në kërkesën e saj dhe ka interpretuar gabim përmbajtjen e nenit 8, paragrafi i dytë, të ligjit “Për organizimin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese” për arsye se këtu nuk kemi të bëjmë me një akt normativ (akt nënligjor), që vjen në kundërshtim me një ligj ose me ligjin kushtetues, por ndodhemi përpara ligjeve, të cilët, siç pretendon ajo gjykatë, vijnë në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Kundërshtimet eventuale, që mund të ekzistojnë ndërmjet dy ligjeve të shpallura dhe të hyra në fuqi në kohëra të ndryshme, nuk mund të shërbejnë si bazë dhe nuk mund të formojnë një shkak për të kërkuar dhe shpallur një ligj të papajtueshëm me Kushtetutën.

Kodi i Ri i Procedurës Penale ka hyrë në fuqi më vonë se ligji nr.7873, datë 16.11.1994. Ai ka karakterin e një ligji të përgjithshëm dhe rregullon në tërësi lëndën. Ky Kod (neni 524) abrogon shprehimisht vetëm kodin e mëparshëm, ndërsa ndaj dispozitave të tjera ligjore të mëparshme, përdor shprehjen e përgjithshme : “Çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë Kod”. Pra nuk ndodhemi përpara një shfuqizimi të shprehur dhe të përcaktuar mirë, i cili ndalon lindjen e çdo dyshimi dhe çdo pasigurie.

Në këto rrethana, në rastin konkret, shtrohet problemi juridik : Cilat dispozita të Kodit të Ri të Procedurës Penale janë të papajtueshme me ligjin e mëparshëm nr.7873, datë 16.11.1994 dhe në çfarë mase.

Ky problem juridik duhet të zgjidhet nga vetë gjykata që gjykon çështjen duke i vënë ballë për

ballë dispozitat e Kodit të Ri të Procedurës Penale me ato të ligjit në fjalë dhe me një vendim të arsyetuar (abrogimi nuk prezumohet) të shprehet nëse ligji nr.7873, datë 16.11.1994 është shfuqizuar tërësisht ose vetëm disa nene të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

Kthimin e materialeve të çështjes Gjykatës së Rrethit Vlorë.
Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.
Tiranë, më 9.2.1996